

**VENDIM**  
**“PËR VENDOSJE SEKUESTRO PREVENTIVE”**

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë e përbërë nga :

**GJYQTARE: BLERINA MUÇA**

Asistuar nga sekretarja gjyqësore Evanthi Bala, në Tiranë, date 08.07.2011, shqyrtoi kërkesën që i përket:

**KËRKUES:** Prokuroria e Rrethit Gjyqësor, Tiranë përfaqësuar nga prokurorja Daniela Sulaj.

**OBJEKTI :** Vendosje e sekuestros preventive per procedimin penal nr. 4155 viti 2010.

**BAZA LIGJORE :** Neni 36 i Kodit Penal dhe neni 274 pika 2 i Kodit te Procedures Penale.

Gjykata, pasi dëgjoi prokuroren që kërkoi pranimin e kërkesës, shqyrtoi materialin procedues,

**VËREN**

Nepermjet kerkeses se Prokurorise se Rrethit Tirane, depozituar ne Gjykate ne daten 08.07.2011, kerkohet te vendoset sekuestro preventive mbi dy pasuri te paluajtshme te regjistruara ne pronesi te shoqerise “LAJTHIZA INVEST” shpk, shoqeri e cila rezulton me aksionere e vetme L.E, bashkeshorte e personit nen hetim H.E. Nga aktet shoqeruese te kerkeses rezulton sa me poshte:

Ne date 13.10.2010, Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Tirane ka regjistruar procedimin penal Nr. 4155, per vepren penale te “Pastrimit te produkteve te vepres penale”, “Kontrabandes me mallra qe paguhen akcize” “Mashttrimit” dhe “Shperdorimit te Detyres”, vepra penale keto te parashikuara nga nenet 287, 172, 143/2 dhe 248 te Kodit Penal.

Gjate fazes se hetimeve, mbi kerkesen e Prokurorise se Rrethit Gjyqësor Tirane, nepermjet Vendimit Nr. 404 date 05.03.2011, kjo gjykate ka vendosur te caktojte masen e sigurimit personal “Arrest ne Burg” per te dyshuarin H.E, dyshuar per veprat penale te “Mashttrimit”, parashikuar nga neni 143/2 i Kodit Penal, te “Falsifikimit te Dokumentave”, parashikuar nga neni 186/2 i Kodit Penal dhe “Pastrimi i produkteve te naftes”, parashikuar nga neni 287 i Kodit Penal.

Nga provat e administruara gjate hetimeve te metejshme, konkretisht shkrese e ZVRPP Puke, me nr. 194/1 prot. date 15.04.2011, nuk rezulton te kete te regjistruar ne emer te H.E dhe shoqerise “Euroil” sha, ku ky shtetas eshte aksioner i vetem. Nga permbajtja e se

njejtes shkrese rezulton qe ne emer te shoqerise “LAJTHIZA INVEST” sha, ku shtetasi H.E eshte drejtues ligjor, figuron e regjistruar pasuria si me poshte:

*“siperfaqja 775m2 truall + Ndertese, ZK ....., me nr. pasurie....., vol. 1, faqe 62, e ndodhur ne fshatin ..... Komuna Qaf-Mali.”*

Nga ekstrakti i Qendres Kombetare te Regjistrimit date 13.06.2011, rezulton qe shoqeria “LAJTHIZA INVEST” sha, me NIPT J98009202P, eshte regjistruar si person juridik ne 07.09.1999, me seli ne Kukes, Qafe e Malit. Aktualisht, kjo shoqeri rezulton me aksionere e vetme Znj. L.E. Ne pasqyrat financiare te subjektit “LAJTHIZA INVEST” sha, per vitet 2009 dhe 2010, rezulton te jene pasqyruar si aktive afatgjata toka dhe ndertesa.

Nepermjet çertifikates familjare nr. 000165285 date 07.07.2011, leshuar nga Zyra e Gjendjes Civile, Njesia Bashkiake nr. 1 Tirane, rezulton qe shtetasja L.E te jete bashkeshorte e personit nen hetim H.E dhe femija i madh i lindur nga martesja, eshte i datelindjes 27.04.1992, pra para krijimit te shoqerise “LAJTHIZA INVEST” sha me NIPT J98009202P. Ne referim te parashikimeve te Kodit te Familjes ne fuqi, neni 74/ç i tij, ne bashkesine ligjore hyn edhe veprimtaria tregtare e krijuar gjate marteses.

Neni 274 pika 2 i Kodit te Procedures Penale, parashikon rastet e vendosjes se sekuestros preventive mbi pasurite qe mund te lejohen te konfiskohen, sipas percaktimeve te nenit 36 te Kodit Penal. Kjo dispozite penale, mes te tjerash ne piken 1.ç te saj, parashikon si sende te konfiskueshme *çdo pasuri tjeter, vlera e se ciles korrespondon me ate te produkteve te vepres penale.*

Nisur nga sa me lart, pasuria e paluajtshme e regjistruar ne ZVRPP Pukene pronesi te shoqerise “LAJTHIZA INVEST” sha, me aksionere te vetme bashkeshorten e personit nen hetim, perben pasuri mbi te cilen mund te vendoset sekuestro preventive. Nepermjet kesaj mase, urdherohet ZVRPP Puke, te mos lejoje tjetersimin e kesaj pasurie, per llogari te procedimit penal nr. 4155 viti 2010.

Per rrjedhoje, gjykata, ne perfundim te shqyrtimit te kerkeses arrin ne perfundimin se plotesohen kushtet dhe kriteret ligjore te percaktuara ne nenet 274/2 te Kodit te Procedures Civile dhe 36 pika 1.ç te Kodit Penal, per vendosjen e sekuestros preventive mbi pasurite e paluajtshme te regjistruara ne ZVRPP Puke, ne pronesi te shoqerise “LAJTHIZA INVEST” sha me NIPT J98009202P.

### **PËR KËTO ARSYE**

### **Konform nenit 274/2 te K.Pr.Penale dhe nenit 36 te Kodit Penal**

### **VENDOSI**

- Pranimin e kerkeses se Prokurorise se Rrethit Gjyqesor Tirane.

- Vendosjen e sekuestros preventive mbi pasurite e paluajtshme te regjistruara ne ZVRPP Puke, ne emer te shoqerise “LAJTHIZA INVEST” sha me NIPT J98009202P, si me poshte:

*“Siperfaqja 775m2 truall + Ndertese, ZK ....., me nr. pasurie ....., vol. 1, faqe 62, e ndodhur ne fshatin ....., Komuna Qaf-Mali.”*

- Urdherohet ZVRPP Puke te mos kryeje asnje veprim tjetersimi mbi pasurite e mesiperme.
- Ngarkohen Oficeret e Policise Gjyqesore te Drejtorise Kunder Krimet Financiar ne Drejtorine e Pergjithshme te Policise se Shtetit.
- Kunder vendimit lejohet ankim sipas ligjit ne Gjykatën e Apelit Tirane.

**Tiranë, me 08.07.2011**

**SEKRETARE**

**GJYQTARE**

**EVANTHI BALA**

**BLERINA MUÇA**